

Nr. Prot.: 3960/25; Data: 14.11.2025

Në bazë të vendimit nr. 188/25, të datës 27.01.2025 të Këshillit Drejtues, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), me datën 14.11.2025, UShAF shpallë:

## KONKURS

Për ndarjen e bursave për vitin akademik 2025/26, për stafin e UShAF, të cilët ndjekin studimet e doktoraturës

### I.

#### Kushtet e përgjithshme

1. Të drejtë aplikimi për bursë kanë i gjithë stafi në marrëdhënie të rregullt pune në UShAF, të cilët janë studentë aktual në studimet e doktoraturës në ndonjë universitet në Kosovë apo jashtë Kosovës.
2. Kandidatët të cilët konkurojnë për përfitimin e bursës sipas pikës 1, duhet të bashkangjesin vërtetimin me të cilin dëshmojnë se janë studentë aktual, të lëshuar nga Institucioni i Arsimit të Lartë, ku ata janë duke studiuar dhe të njëjtit nuk kanë përfituar bursë nga UShAF më herët gjatë studimeve të doktoraturës.
3. Dokumentet e kompletuara dorëzohen fizikisht në Zyrën për çështje akademike të UShAF.

Administrata Qendrore është e obliguar që në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë konkurs, t'i përgatit listat e kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret për përfitimin e bursës universitare;

### II.

#### Afati për aplikim

Afati i aplikimit është prej datës 14.11.2025 deri më 20.11.2025 ora 15:00.

### III.

#### E drejta e ankesës

Kandidatët të cilët konsiderojnë se kanë pasur të drejtë të përfitimit të bursës universitare dhe nuk janë përfshirë në listën e kandidatëve përfitues të bursës, kanë të drejtë ankese tek Komisioni për ankesa, në afat prej 48 orësh pas ditës së publikimit të listave.

Ankesat duhet të dërzohen në Zyrën për çështje akademike.

